

HULUMTIM MBI FUNKSIONET, CILËSITË DHE PËRBËRJEN E KRYETARËVE TË DEGËVË TË ISH-SIGURIMIT TË SHQIPTARËVE

Z. Gjergj Marku

Grupi i punës: Marvina Shtylla, Gerald Vjollca, Eglantina Daulle, Elibjana Buçpapaj.

BIO

Gjergj Marku është anëtar i zgjedhur i Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH), duke shërbyer në këtë detyrë që nga viti 2022, në mandatin e tij të parë si pjesë e organit kolegjal të vendimmarrjes së institucionit. Ai ka një përvojë të gjatë në administratën publike dhe në angazhimin qytetar e shoqëror, veçanërisht në çështjet që lidhen me kujtesën historike, të drejtat e ish-të përndjekurve politikë dhe dokumentimin e krimeve të regjimit komunist në Shqipëri. Për më shumë lexoni bio e plotë [këtu](#).

Abstrakt

Në kuadër të mbajtjes së konferencës ndërdisiplinore “*Aspekte të Përndjekjes Politike të ish-Sigurimit të Shtetit Shqiptar (1944-1991)*”, Autoriteti ka ngritur grupin e punës me kryetar Z. Gjergj Marku, me fokus hulumtimin e funksioneve, cilësive dhe përbërjes së kryetarëve të degëve të ish-Sigurimit të Shtetit me qëllim përpilimin e një materiali mbi gjetjet dhe prezantimin e tij në konferencë.

Kërkimi dhe mbledhja e informacioneve për kryetarët e degëve të ish-Sigurimit të Shtetit me fokus evidentimin e strukturës së ish-Sigurimit të Shtetit, rolin e tyre si struktura represive lokale, urdhërat që zbatonin etj., janë synimi i këtij hulumtimi.

Metodologjia, që do të përdoret për shtjellimin e këtij studimi, është metodologjia hulumtuese, e cila përqëndrohet tek analizimi i dokumentave origjinale pjesë e arkivës së Autoritetit apo arkivave të tjera sipas nevojës dhe shqyrtimi i fakteve, duke bërë të mundur zbardhjen dhe qartësimin e pozicionit të kryetarëve të degëve, vendimeve me fuqi zbatuese, informacioneve të përcjella, propozimeve e çdo veprimtari/detyrë tyren si pjesë e funksionit që kryenin. Kërkimi fillestar do të nisë me Drejtorinë e Parë të Sigurimit të Shtetit, fondi numër 4 (fond administrativ), me mjete informimi: Inventari i dosjeve fizik dhe elektronik. Ky kërkim mund të shtrihet dhe në Dosje nga Fondi numër 1 Hetimor-Gjyqësor, Fondi Nr. 49, Dega e Hetuesisë, Fondi Nr. 142, Komunikatat Operative (1949-1991) si dhe fonde të tjera, për gjetje më konkrete për përzgjedhjen e rasteve specifike që do të prezantohen. Shterimi i kërkimeve do të quhet i realizuar me arritjen e qëllimit të hulumtimit.

Një ndër tiparet e veçanta të regjimit totalitar të instaluar në Shqipëri, ishte ndëshkueshmëria jo me bazë ligjore-rationale, por me bazë emocionale e udhëhequr nga lufta e ashpër klasore dhe si rrjedhojë edhe institucionet e krijuara udhëhiqeshin nga këto norma. Nën petkun e kuadros së ish-Sigurimit qëndronin dhe kryetarët e degëve, përgjegjës për internime, burgosje dhe persekutime, shpesh duke zbatuar dhe urdhra për konfiskime pronash. Armiqtë e tyre ishin kundërshtarët politikë. Ata përpilonin raporte sekrete për aktivitetet e kundërshtarëve politikë, apo gjendjen e të burgosurëve politikë dhe vepronin si dora e zgjatur e regjimit në rrethe. Sanksionet e marra nga këto kuadro, masat e ndëshkueshmërisë, binin totalisht ndesh me të drejtat e njeriut në demokraci dhe ishin gati ç’njerëzore.

Qëllimi i hulumtimit është që të paraqesë në mënyrë të përgjithshme, një tablo të qartë të veprimtarive të kuadrove si zbatues të funksioneve të organeve të ish-Sigurimit dhe të zërthejë hierarkinë e zbatuar duke bërë të mundur gjetjen e tejkalimit të urdhrave që merrnin nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe se si ndikonte kjo në fatin e të dënuarve politikë. Ndikimi i tyre në zbatimin e sistemit komunist ka qenë i një shkalle sipërore dhe një hallkë e rëndësishme e strukturës së ish-Sigurimit.

Pritshmëritë

Nëpërmjet këtij studimi synohet, që të arrihet ky objektivi, të realizohen sa më shumë hulumtime rreth kryetarëve të degëve, ndëshkimeve të padrejta dhe pasqyrimi i tyre me të dhëna kredenciale.

Fjalë kyçe: *kryetarë dege, rrethe, burgosje, internim, persekutim.*